

Bardhyl DËMIRAJ

NUMËRORI NJË NË GJUHËN SHQIPE - VËSHTRIM DIAKRONIK¹

Me veshjen fonetike [nə] <një>, të normëzuar edhe në gjuhën letrare shqipe, ky numër i ka errësuar lidhjet etimologjike me se cilën nga temat mbiemërore që dëshmohen në gjuhë të ndryshme indoевropiane: */oinos/ (:*/(H)oi-no-s/), khs, gr. *oivη* f., *οἰνός* m., lat. *ūnus* (<*oinos*>), ir. vj. *oēn*, go. *ains* "një"; */oiuos/ (:*/(H)oi-uo-s/), khs. pers. vj. *aiva* - "i vetëm, një", gr. *οἴφος* "i vetëm"; */oikos/ (:*/(H) oi-ko-s/), khs. ind. vj *éka-* "një"; */sem-/ , */sm-/ : gr. ε ις , tok. A *sas*, B *se* "një", sll. vj. *samb* "vetë" etj.². Kjo ka sjellë si pasojë që në inter- pretimin diakronik të këtij numërori gjuhëtarë të ndryshëm, albanologë dhe indoevropianistë, të mbajnë qëndrime të ndryshme (§ 1.1.4).

Hulumtimin diakronik të këtij numërori e kanë vështirësuar deri diku edhe disa çështje ende të pazgjidhura në planin krahasues të brendshëm, të cilat lidhen me larminë funksionale dhe formale të njësisë *një* në periudhën e dokumentuar të gjuhës shqipe si edhe sot në dialektet e të folmet e diasporës shqiptare. Kështu p.sh., kjo njësi përdoret sipas rastit me funksionin e numërorit, të përemrit të pacaktuar e të nyjës joshquese (§ 1.1.1). Ajo del gjithashtu në një numër formash që mbartin edhe tregues gramatikorë (§ 1.1.2). Në këtë

1 Marrë nga: Bardhyl Demiraj: *Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1997

2 Sh. ndër të tjerë Bopp *Zahlwörter* 131v.; Brugmann *Grundriß* II/2, 6vv.; Frisk II 367; Szemerényi *Einführung* 235; Windekens IF 87 [1982] 14. Emërtimet e ndryshme për numërорin "një" në gjuhët indoevropiane, tregonë se në protoindoевropianishtë nuk ishte përgjithësuar një shprehje e veçantë për nociionin abstrakt të këtij numri (Brugmann vep. cit. 6, 335). Për shprehjen e këtij nociioni kanë shërbyer formimet mbiemërore */(H)oi-no-/ , */(H)oi-uo-/ , */(H)oi-ko-/ me burim nga tema përemërore */(H)oi-/ ose përemri vjetvotor */sem-/ , */sm-/ (Szemerényi vep. cit. 235, 236).

mënyrë, si nevojë e dorës së parë në interpretimin etimologjik shtrohet zgjidhja e çështjeve që vijojnë: a) përcaktimi i funksionit burimor të njësisë *një*, prej të cilit kanë rrjedhur edhe funksionet e tjera; b) rindërtimi i një paraforme të përbashkët shqipe, prej së cilës janë përfshuar edhe variantet tjera, si dhe arsyet e përfshimit të tyre; c) saktësimi i kronologjisë relative dhe absolute për përfshimin e strukturës fonologjike [nə] së bashku me funksionin gjegjës.

1.1.1. Përcaktimi i funksionit burimor të kësaj njësie kufizohet ndërmjet përdorimit të saj si numëror dhe atij si përemër i pacaktuar. Përdorimi i saj me funksionin e nyjës joshquese është i një periudhe relativisht të vonë. Ai është përfshuar pas lindjes së nyjës shquese, përkatësish të kategorisë gramatikore të shquarësisë e të pashquarësisë në gjuhën shqipe, prej përemrit të pacaktuar *një* për të shprehur më mirë kuptimin e pacaktuar në kundërvënie me kuptimin e caktuar të një emri të përgjithshëm të përdorur në mënyrë të individualizuar (me nyjë shquese): *njeriu ~ një njeri*³.

Në lidhje me raportin kronologjik midis funksioneve *numëror ~ përemër i pacaktuar*, të dhënat e gjuhës shqipe dhe të indoevropianistikës të çojnë në pranimin e shfaqjes më të hershme të funksionit numëror të njësisë *një*. Funksionimi i përemrit të pacaktuar është rrjedhojë e përdorimit të numërorit *një* me një kuptim (të përgjithshëm) të pacaktuar, ku ideja e sasisë kalon në plan të dytë⁴. Në rastin konkret, duhet vënë në dukje se përdorimi i njësisë *një* si përemër i pacaktuar u takon periudhave të vona të gjuhëve të ndryshme indoevropiane dhe nuk ka lidhje me bazat përemërore indoevropiane (dëftore e vetvetore), prej të cilave është përfshuar ky numëror në këto gjuhë⁵

1.1.2. Vështirësitetë e shqyrtimit diakronik rriten gjatë shtjellimit të çështjes së dytë, që ka të bëjë me përcaktimin e strukturës fonologjike dhe gramatikore të një paraforme gjithëpërfshirëse, e cila do të mbulonte me kohë të tri funksionet e trajtuar në paragrafin e mësipërm. Lidhur me strukturën fonologjike të kësaj njësie, duhet vënë në dukje se në shqipen e sotme letrare është përgjithësuar forma *një* në të gjitha funksionet gramatikore: a) si numëror: *C'të bënte ai*

3 Sh.Demiraj *Gramatikë* 302v.

4 Sh.Demiraj *Gramatikë* 525. Për gjuhë të tjera indoevropiane sh. Sommer *Handb. Lat* 440v.; Mayrhofer EWA I 262v.

5 Si përemra të pacaktuar të burimit indoevropian dëshmohen temat përemërore që nisin me një tektal labiovelar: */kʷe-/; */kʷi-/; */kʷo-/; */kʷu-/; të cilat përdoren edhe si përemra pyetës e lidhorë; sh. Brugmann *Grundriß II/2*, 348v.; Szemerényi *Einführung* 220v.

vetë një kundër treve! Jo, jo; një kundër katërve me gjithë Skënderin. Një dritare në ballë, një trapezë dhe pesë karrige...etj.; b) si përemër i pacaktuar; U takova me një që s'e kisha parë ndonjëherë. Është një nga të mitë etj.; c) si nyje joshquese: Është një djalë që s'e ka shokun. Punonte me një shoqe etj.

Një situatë disi e ndryshme paraqitet në letërsinë e vjetër shqipe, në dialektet dhe në të folmet e diasporës shqiptare. Buzuku përdor përgjithësisht formën *një* (gj. -dh. -rr *njëj*)⁶, pavarësisht nga funksioni ose pozicioni sintaksor i theksuar, përkatësisht i patheksuar⁷: *E grishi kâ një e kâ një gjithë detorësitë e d zot* (fol. LXXV/3, 387); *U njoh një nieri* (fol. XL/2, 109); *E një n shumicet e tha* (fol. XLV/1, 129), *një nier* pat dy bij... me hî m ndë qytet një ditë t'ecunë (fol. LX/2, 189); *Atëherë vote një n se dymbëdhjetësh* (fol. LXIV/2, 205); ...*një natë e një ditë* (fol. XL/2, 109); ...vëllazënë, as nukë dini se shumë rjedhënë mbë Palit, ma një e mer Palinë? (fol. (IXL=) XXXVIII/3, 107); ...me *njëqind* vetë ajo me *njetunë* në një natë, ajo si të mos kish fjetunë as me një burë (fol. LXXXI/2, 349); ...tue klenë gjithë njëj vollundetje (fol. LXXVIII/3, 379).

Tek Matrënga ndeshet më shpesh forma *një*: *Pse me një të vetëmë vlemë të tii* (drsh. 1, 39^v); ...*e bënj një të fortë vulii..* (drsh. 1, 32^v); *Ishte një kujtim...* (drsh. 1, 39^v); *Si ka të gatuhetë një se të marë me vlavie kurminë shejt të krishtit* (drsh. 1, 40). Në rasat gjinore-dhanore haset te ky autor forma *njij* (§ 1.1.2.3.3.).

Tek Budi ndeshen tri forma: *nja*, kryesisht në pozicion të theksuar; *një*, kryesisht në pozicion të patheksuar; dhe *nji* që ndeshet në mënyrë sporadike në pozicion të patheksuar si shoqëruese e një emri (në DC vetëm dy raste)⁸: ...*e m i thuoj gjithë kaa nja kaa nja* (DC 146 23); ...*vonë për gjithë kaa nja ncosh* (DC 152 23); *Ndë e vonë nja i rae e për dhee e rrëzoj...* (DC 207 1); ...*këha ndë një ças fiënë e parë* (DC 2 27); ...*ashtë një e vetëme Zotëni* (DC 6 17); *E një të dashunë e të mirë aqë të madh* (DC 10 15); *Një herë nji i kërshtenë e një xhudhii* (DC 7 3); ...*se njii i vetëmi i Biri Tinëzot* (DC 11 2).

6 Për format (*i*) *njaj* dhe *njāni* sh. §§ 1.1.2.2v.

7 Me pozicion të theksuar, përkatësisht të patheksuar do të kuptojmë përdorimin sintaksor të njësisë *një* si gjymtyrë e mëvetësishme, përkatësisht e pamëvetësishme (si shoqëruese e gjymtyrëve të tjera). Në gjendjen e sotme të gjuhës kjo ndarje bëhet si vijon: si gjymtyrë e mëvetësishme njësia *një* del vetëm në funksion përemëror ose si numëror i emëruar, ndërsa si gjymtyrë e pamëvetësishme ajo përdoret me funksionet e numërorit të mirëfilltë dhe të nyjës joshquese.

8 Tek Bardhi është disi e vështirë vendosja e këtij kriteri të përdorimeve, pasi forma e theksuar *nja* del shpesh edhe në pozicion të patheksuar.

Bogdani përdor kryesisht dy forma, *nji* (gj. -dh. -rr. *njij*) në pozicion të patheksuar dhe *nja* në pozicion të theksuar:....*anshtë nji libër i çelë* (Scal.I Lig.I, 2); ...*po ka diku nji Zot fort të begatë e të lum* (po aty f.3); ...*përse kjenë gjithë njij gjuhe e mirrinë vesht* (po aty, f.4); ...*nja leu nja, e ndë vetëhe drodh të dashunitë e vet...* *Njofta nja* qì bāni gjithë, e tjetërinë, me të sivjet gjithë kafsha u bā (po aty 2).

Në të folmet e ndryshme dialektore, situata paraqitet si vijon⁹: në gegërishte është vendosur marrëdhënia *nja(/ā) ~ nji (ni, i, in* në varësi me pozicionin sintaksor të theksuar, përkatësisht të patheksuar¹⁰. Kjo marrëdhënie ndeshet edhe në disa të folme kalimtare dhe arbëreshe¹¹, kurse në të folmet toske përdoret përgjithësisht forma *një* në të dyja pozicionet¹².

1.1.2.1. Forma e patheksuar *nji* e gegërishtes, së bashku me variantet e saj *ni, in, i*, duhet të jetë përfstuar relativisht vonë nëpërmjet qiellzorëzimit të mëtejshëm të fonemës /ə/ në pozicion të patheksuar, siç ndodh edhe në raste të tjera të tipit *qeroj ~ qiroj, që ~ qi; gjëmon ~ gjimon* etj.¹³ Duke mënjanuar formën *nji (ni, in, i)* nga fazat më të hershme të zhvillimit gjuhësor, shqyrtimi diakronik kufizohet në marrëdhënien formale *nja ~ një*, përkatësisht në çështjen se cila prej këtyre formave është më e hershme në boshtin kronologjik. Duhet vënë në dukje këtu se kjo marrëdhënie përbën në të njëjtën kohë edhe një problem të dialektologjisë historike, pasi përkon me dallimin dialektor t. /ə/ (e theksuar) ~ g. /ā/, khs. t. *rërë ~ g. rānē*, t. *është ~ g. ā(n)shtë*, t. *mëz ~ g. māz* etj.¹⁴. Këtu do mbajtur parasysh edhe fakti që të njëjtës shpërndarje dialektore i nënshtrohen edhe trajtat e shquara të përemrit të pacaktuar *një*: khs. t. *njéri ~ g. njāni*.

1.1.2.2. Marrëdhënia formale *një ~ njā* do të zgjidhej me lehtësi ose në të mirë të variantit hundor *njā*, ose duke pranuar një zhvillim të njëkohshëm të të dy varianteve, në rast se kjo ndarje nuk do të binte ndesh me disa "çrregullsi gege" që vërehen te Buzuku (e deri diku

9 Të dhënat dialektore i kemi nxjerrë nga Kartoteka e Dialektologjisë pranë Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë në Tiranë, si edhe nga vjetjet tonë botimet *Folklor Shqiptar I (Proza Populllore I-IV)*, Tiranë, 1966; *Folklor Shqiptar II (Epika Legjendare)*, Tiranë 1966.

10 Në disa të folme, sidomos në ato të gegërishtes verilindore, forma *nji* po konkurron ndërkohë edhe formën *nja* në pozicion të theksuar.

11 Sh. për të folmen arbëreshe të Falkonarës Huld BAE 101.

12 Kumtim me gojë prej Jorgji Gjinarit.

13 Sh. Çabej *Hyrje* 99v.; Gjinari *Dialektet* 145v.

14 Sh. Çabej *Hyrje* 100; Ölberg *Diss. Albanicae* 13 [1971] 176; Ismajli *KSI* II [1972] 152; Janson *Rhotazismus* 202v.; Gjinari *Dialektet* 188v.

edhe te Budi). Siç u shtjellua më lart (§ 1.1.2.), të ky autor kundërvenia pozicionale *i theksuar ~ i patheksuar* për njësinë *një* nuk dallohet grafikisht, duke pasqyruar kështu të njëjtën situatë si te Matrënga dhe në të folmet toske¹⁵. Nga ana tjetër, për përemrin e pacaktuar në trajtë të shquar te Buzuku (ashtu si te Budi) gjemjë të përdorur edhe variantin me zanore hundore *njani* [nāni], khs.: *Njani anshtë se kondra ordhënitë Tinëzot yete, e i dyti kati qi...* (Buzuku fol. XXXVIII/3, 103); ...*njani* për tjetërit (Budi DC 3 26; 7 4); ...*njani* me tjetërin (Budi DC 142 8); ...*njani* mbas tjetërit (Budi DC 3 13) etj.

Në këtë situatë problemi duket sikur vihet para alternativës: ose duhet të pranojmë edhe për gegërishten një formë parësore me fundoren /-ə/ (Buzuku, Budi)¹⁶, përrjedhojë forma gege me /-ā/ të jetë dytësore, gjë që në pamje të parë bie në kundërshtim me formën e përgjithësuar *njāni* të Buzukut e të Budit, ose të dhënat e këtyre dy autorëve nuk pasqyrojnë gjendjen reale të gegërishtes.

1.1.2.2.1. Zgjidhja e drejtë e kësaj çështjeje është e lidhur ngushtë me funksionin parësor morfologjik dhe sintaksor të njësisë në shqyrtim, si edhe në veçoritë e karakterit fonologjik që i vishen atij funksioni. Siç u vu në dukje edhe më lart (§ 1.1.1), njësia *një* në gjuhën shqipe ka ndjekur vijën kronologjike funksionale *numëror i mirëfilltë → përemër i pacaktuar → nyje joshquese*. Përgjatë këtij kahu kohor, ajo, duke qenë fillimisht numëror i mirëfilltë, përdorej sintaksorisht me funksionin e një përcaktori të pavetëmjaftueshëm, d.m.th. në çdo rast si shoqëruese e emrave ose e pjesëve të tjera të ligjëratisës, khs. *një burrë e jo dy burra*. Në këto togje fjalësh ajo ka pasur kurdoherë një theksim të dobët, çka tumiret prej formës toske e buzukjane *një* me zanore të reduktuar.

Nga ana tjetër, kjo njësi ndeshet edhe si gjymtyrë e veçantë (kryesore) në fjalë. Fjala është përrastet kur ajo përdoret si përemër i pacaktuar: *një vjen e një shkon*; ose si numëror i emërzuar, me vlerën e gjithë togut *numëror + emër*: khs. *erdhi një (burrë) e jo dy*. Në këtë funksion sintaksor ajo mbartte detyrimisht theks mbi vete. E ndërsa kjo situatë do të ishte krejt normale në dialektin tosk ajo nuk mund të

¹⁵ Sipas Çabej (Meshari I, 67v.) te Buzuku është gjithkund i pranishëm sistemi i zanoreve hundore. Por mendimi i tij në Hyrje (f.100) se edhe gegërishtja ka pasur dikur një zanore të theksuar, duhet kufizuar vetëm në ato pak rasa, kur disa fjalë kryesisht proklitike, përkatësisht përcaktorë të pavetëmjaftueshëm, përdoren sipas rastit edhe si gjymtyrë (të mëvetësishme) të fjalisë, khs. (Buzuku) *një, atë, këtë*.

¹⁶ Këtë mendim mbron Çabej (SE, lema *një* - e pabotuar), por pa dhënë shpjegime të mëtejshme për parësinë e saj.

ruhej si e tillë edhe në dialektin geg, në sistemin fonologjik të të cilit zanorja /ə/ e theksuar mungon. Në këtë mënyrë, shpjegimi i formës geje *njā* si variant dytësor, analogjik paraqitet plotësisht i mundshëm. Shndërrimi analogjik dialektor /nə/ → g. *njā* duhet të ketë filluar para shek.XVI (Buzuku). Të Budi ndeshen vetëm gjurmë të situatës më të hershme gjuhësore të dialektit geg, ku njësia *një* në këtë dialekt e ruante ende strukturën fonologjike /nə/ edhe kur përdorej si gjymtyrë kryesore në fjali.

1.1.2.2.2 Ndaj tezës së mësipërme vështirë se mund të sillet si kundërgjithësia argument struktura fonologjike e trajtës së shquar të përemrit të pacaktuar t. *njéri* ~ g. *njāni* <^o/nani/. Kjo trajtë duket të jetë gjithash tu një riformim i mëvonshëm analogjik prej emrave me temë në ^o/-n-/ të tipit ti. *zë*, *-ri* ~ g. *zā*, *-ni*, t. *pe*, *-ri* ~ g. *pē*, *-ni* etj., një dukuri kjo e shpeshtë në sistemin emëror të shqipes: khs. t. *ulli*, *-ri* ~ g. *ullī*, *-ni* < shq. ^o/uli(n)-/ < lat. *ok̥va*¹⁷.

Shkas për riformimin analogjik të këtij përemri ka dhënë, pas gjithë gjasash, homonimia e përfshuar prej shtimit të nyjës shquese në temën e pazgjeruar të këtij përemri me rasat e zhdrojta të njësisë *një* në përgjithësi. Këtë mendim e përforcojnë edhe disa raste sporadike në *Mesharin* e Buzukut, ku ky përemër del me temë të pazgjeruar: *njēi/j*, *njai/j*, krahas përdorimit të tij të rregullt me temë të zgjeruar: *njani* [nāni], khs.: shembuj me përemër të pacaktuar: *Ishnë dy detorës njēi* [= *njanit* -B.D.] *qi ep uā: e njē* [= *njāni*-B.D.] *kish me dhanë pesëqind denarë e tjetëri pesëdhjetë* (fol. LXII/1, 197); ...*blenë një copë dhë n njai* [= *njānit* -B.D.] *qi ban urcoj, e aj dhë me klenë për vore shtekëtarëve* (fol. LV/1, 209)¹⁸, ...*përsë fort janë të vëjyeme të lutunatë e pāpushime e njaj* [= *njānit* -B.D.] *qi anshtë i dërejtë* (fol. LXVIII/3, 259); *U jam zani i d njai* [= *njānit* -B.D.] *qi thërret ndë dezertit* (fol. XXX/4, 87); shembuj me numëror ose nyjë joshquese: *Nd atë mot, tue pasunë h̄m Jezu ndë shtëpitë t njej n krenëshit...* (fol. LXXVIII/1, 297); *Mbramanet, njëj mbrambe djerie m tjetërët ju të pushoni* (fol. LXXIX/3, 303); *Pistullinë ecë e vgvaj ndë komut tē njai Munduosi* (fol. LXXXVIII-IX/4-1, 339-41).

1.1.2.2.3 Me strukturën morfologjike të njësisë *një* lidhet edhe trajtimi diakronik i treguesit morfologjik të rasave të zhdrojta. Ky

17 Sh. për këtë Demiraj *Gramatikë* 148. Nuk gjen mbështetje mendimi i Camarda-s (*Gr. Co. I* 169), sipas të cilit *njéri/njāni* është një formim me dyfishim i formave *një*, *nja* ose *nji*

18 Në të njëjtën frazë, disa freshta më poshtë, ky përemër zëvendësohet me një përemër dëftor, të përdorur me kuptim të pacaktuar: khs...e i dhanë një copë dhe t ati *qi ban urcoj, porsi më ordhënoi Zotynë*

tregues del rregullisht tek autorët e vjetër, si edhe sot në disa të folme konservatore: khs. *E ishni gjithë njëj zemëre; E të meri të parënë ditë pemë n njëj lisi së bukurë; ...e shpunë djerie maje njëj mali* (Buzuku fol. LXXXII/2, 249; LXXIX/3, 203; LI/3, 155); ..., *e ngaa njij i jep për hir të gjëë të bëëme të mira të tii; t'i falësh njij të vetëmi tinazot* (Matrënga drsh. 1, 36^v; 31); ...*ashtë një e vetëme zotëni, e njaj natyre i paadaam;* ...ndo makaar veçëse *njax* së vetëmese ncosh; ...për pendesë të *njax* mase (Bardhi 82, 83); ...*përsë kjenë gjithë njij giuhe e mirrinë vesht* (Bogdani Scal. I, Ligj. I, 4) etj.¹⁹

Sic shihet edhe nga shembujt e mësipërm, shenjesi i rasave të zhdrejta, i cili është karakteristik për emrat mashkullorë të lakimit të parë²⁰, i është bashkangjitur formës së ngurrosur *një/nja* (te Matrënga dhe Bogdani edhe *nji-j*). Si i tillë ai nuk mund të rrjedhohet pandërmjetshëm prej treguesve rasorë të optimit përemëror indoevropian: khs. lat. (e.) *ūnus*, (gj.) *ūnius*, (dh.) *uni*²¹. Mbaresën rasore {-i/j} te kjo njësi Demiraj e shpjegon me veprimin analogjik të klasës së emrave mashkullorë të lakimit të parë, ashtu sic ka ndodhur te përemri pyetës *kujt* (:ku-j-t)²². Një ndikim i ngjashëm duket të jetë përfhtar edhe te mbiemri me funksion përemëror (*i*)*njëjtë* (:njëj-të), (Buzuku) (*i*) *njax* (: *nja-j*) "i vetëm; i njëjtë" dhe të format buzukjane të përemrit *se*: (*i*) *sejtë* (: *se-j-të*), *n sej*.

1.1.3 Nga shqyrtimi diakronik brendagjuhësor, rezulton se njësia *një* në gjuhën shqipe ka funksionuar fillimisht si numër i mirëfilltë. Si i tillë, ajo dilte rregullisht në pozicion proklitik brenda togut *numër + emër* (/fjalë e emërzuar). Funksioni fillestar dhe topika përkatëse lejojnë që nga larmia e formave të sotme dialektore, të veçohet forma *një* [nə] me zanore të reduktuar si formë përfaqësuese (paradialektore) e njësisë në shqyrtim. Mosha e strukturës fonologjike /nə/ është e lidhur ngushtë me kronologjinë e zanores së reduktuar /ə/ në sistemin fonetik të gjuhës shqipe, e cila, pas gjitha gjasash, është përfhtar shumë shekuj para Buzukut²³. Pozicioni në zanafillë proklitik i njësisë *një* ka kushtëzuar ndërkokë edhe bjerrjen e shenjesve të dikurshëm gramatikorë që kjo njësi duhet të ketë trashëguar nga fazat më të hershme të zhvillimit të gjuhës.

19 Për të folmen e Çamërishtes sh. Pedersen AT 89, 98.

20 Sh. ndërt të tjerë Demiraj *Gramatikë* 302^v.

21 Sh. Sommer *Handb. Lat.* 440, 464; për greqishten sh. Schwyzer *Gr* 1,588.

22 Sh. Demiraj *Gramatikë* 303.

23 Sh. për kronologjinë e zanores Çabej *BSS* [1956] (1) 123^v.

1.1.4. Shqyrtimi diakronik i mëtejshëm si edhe rindërtimi i formës bazë protoshqipe lidhen drejtpërdrejt me interpretimin etimologjik të numërorit *një* në gjuhë shqipe. Në studimet e derisotme etimologjike në fushë të shqipes është ndjekur si kriter metodik vendosja e lidhjeve etimologjike të drejtpërdrejta me njëren nga temat që dëshmojnë gjuhë të ndryshme indoevropiane: */(H)oi-no-/, */(H)oi-uo-/, */(H)oi-ko-/ dhe */sem-/ , /sm-/ (§1.1). Një numër gjuhëtarësh, si Meyer-i, Jokl-i, Haas-i, La Piana, Çabej etj.²⁴, rindërtojnë për numëronin *një* një formë bazë */onio-/, */enio-/, duke e parë atë përgjithësisht si variante formative të bazës */(H)oi-no-/. Ndryshe mendon Baric-i, së fundi edhe Huld-i, të cilët e rrjedhojnë atë prej bazës */sem-/ , */sm-/ ²⁵. Brugmann-si sheh tepër të errët lidhjen etimologjike me secilën prej këtyre dy bazave ²⁶. Kjo dysi zgjidhjesh parakupton vështirësitë e karakterit fonologjik, semantik dhe fjalëformues që ndesh secila tezë.

1.1.4.1. Kështu p.sh., rindërtimi i Huld-it, sipas të cilit shq. *një* është përfuar nga një paraformë */ni-o/ si "formim regresiv prej formës femërore ie. */smieh₂/"²⁷. ndesh në vështirësi të interpretimit fonologjik, që lidhen me zhvillimet e fonemës */m/ dhe të grüp * /sm/ në gjuhën shqipe. Kjo fonemë paraqitet gjithsesi e mirëruajtur në mjedisin fonologjik në shqyrtim. Mjafton të përmendim këtu fatin e foljeve të zgjedhimit atematik në gjuhën shqipe: *jam*: */h₁es-mi/ , *thom*: */keh₁s-mi/ ²⁸, ose barazimet etimologjike: *muaj* : */meh₁n-s/ , khs. gr. μνω, lat. *mēnsis*, got. *mena* "id." ; (i) *madh* : */m₃g-(e)h₂-/ , khs. ind. vj. *mâhi-*, gr. μεγαζ "id.", *mjekér*: */smek-ᵣ/ , khs. ind. vj. *smásru-*, lit. *smakrà* "id." ejt.

1.1.4.2. Jo më pak vështirësi në interpretimin diakronik përcjell edhe teza që e shpjegon numëronin *një* si një variant formativ i bazës */(H)oi-no-/. Veçojmë këtu mendimin e Meyer-it, i cili pranon

24 Sh. Meyer *EWA* 313v. me literaturë; *AS* III 66; Jokl *IF* 36[1916] 107, Haas *Mess. Studien* 95, 177; La Piana *SLA Varia* 77; Çabej *SE* (lema *një*-e pabotuar).

25 Sh. Baric *ARS* I 64; Huld *BAE* 121. Këtë mendim mbron edhe Klingenschmitt-i në *Alb. Numerals* 22.

26 Sipas Brugmann-it në *Grundriß* II/2, 7, shq. *një*, sikurse numërori gjegjës në sllavishte dhe lituanishte, mund të jetë një kompozim i bazës *onio-* me një element tjetër përemëror. Ky interpretim del më parë edhe te Meyer-i në *AS* II 72. Nuk mban qëndrim për këtë çështje Tagliavini në *AD* 209 Hamp-i (në *TLSM* 57 [1992] 902v. me literaturë) rindërtzon një bazë me dyfishim: */eni-onio-/ > ^o/nién/ > ^o/ñān-/ > *nja*.

27 Me këtë rindërtim autor i duket se ka parasysh formën greke μια f. "një". Sh. për këtë formë Schwyzer *Gr. Gr.* I, 588; Frisk I 471.

28 Për foljet e zgjedhimit në */-mi/ në gjuhën shqipe sh. Demiraj *Gramatikë* 740v. me literaturë.

përqasjen e bërë më parë nga Stier-i me ind. vj. *anyá-* "tjetër" dhe gr. eviot "disa", duke rindërtuar për të tria këto gjuhë varianten formative të përbashkët */eniós/, por pa dhënë për të shpjegime plotësuese²⁹. Pedersen-i shton krahasimit me ind. vj. *anyá-* edhe arm. *ayn* "ai", duke rindërtuar një formë bazë */an-iós-/ me formatin indoevropian të shkallës krahasore *{-ios-}³⁰. Siç shihet, gjuhëtarët e këtij grupi priren kryesisht për të sqaruar problemet e karakterit fonologjik. Rindërtimi i një forme bazë */Vnió-/ motivon njëherazi si qielzorëzimin e hundores */n/ (→ shq. /n/ | -*i/) ashtu edhe bjerrijen e hershme të zanores nistore të patheksuar te kjo njësi.

Ndër shembujt e sjellë për krahasim mbetet tepër i diskutueshëm gr. eviot "disa", që shfaq shmangje të dukshme të karakterit semantik, fonologjik, si p.sh. vendi i theksit³¹. Jo krejtësisht i qartë është edhe krahasimi me ind. vj. *anyá-*, së bashku me rrjedhojat e saj *anyátra* "gjetkë", *anyátha* "ndryshe", që ka gjegjëse vetëm në degën iraniane, khs. av. *aniia-*, pers. vj. *aniya* "tjetër", *aniya aniyam* "njéri nga të tjerët" etj. Duke u trajtuar në lidhje etimologjike me ind. vj. *ántara-* "i brendshëm, i afërm", *anyá* është zërthyer në */an-/ (: */h₂en-/) nuk është arritur ende në një përfundim të përbashkët. Disa indoevropianë vërejnë këtu një barazim analogjikis me pikënisje temën përemërore */hel-/, khs. lat. *alius*, *alter* "tjetër", got. *alja* (=lat. *alius*), *anpar* "id." etj., duke supozuar kështu një shndërrim të hershëm të grupit */-It-/(→*/-nt-/). Të tjerë gjuhëtarë nisen nga tema përemërore */an-/ (: */h₂en-/), si variante formative e dëftorëve deiktikë më */-n-/³². Një variante të tillë pranon edhe Çabej gjatë interpretimit etimologjik të shq. *gjetiu*, dial. *njeti*, *ngjeti*, *gjetkë*³³.

1.1.4.3. Zgjidhja e kësaj çështjeje në të mirë të temës përemërore */h₂en-/ mundëson edhe sqarimin etimologjik të numërorit *një* në gjuhën shqipe. Brenda këtij kuadri, numërori *një* shpjegohet pa vështirësi si formë e zgjeruar më */-io-/ (f. */-ieh₂-/)³⁴ i temës përemërore */h₂en-/: *një* < protoshq. ^o/an̥iV-/ : m. */h₂en-jo-/, f. /h₂en-ieh₂-/.

29 Sh. Meyer AS III 66; një rindërtim i ngjashëm edhe te Jokl-i në *IF* 36 [1916] 107.

30 Pedersen *Les pron.* 35v.

31 Sipas Boisacq-ut në *DELG* 254 me literaturë, gr. evi oī "disa" është përfstuar nga ngjizja e grupit parafjalor evi oī. Kritikë te Frisk I 518v.

32 Sh. më gjérë për këtë problem Mayrhofer *EWA* I 80.

33 Çabej, *Fs. Bonfante* [1976] 108.

34 Ky zgjerim s'mund të barazohet me formantin ie. *{-ies-}, *{-ios-}, *{-is-} (Pedersen *Les pron.* 35v.), gjurmët e të cilit ruhen ende në shqipe: (i) *madh* pranë *madhështi* (: *madh-ësh-ti*).

Në radhitjen e dukurive fonologjike të përftuara te kjo njësi, vend qëndror zë qielzorëzimi i grupit */-nj-/ → shq. /n/. Në pikëpamje kronologjike, ai përkon në kohë me qielzorëzimin e shënjesit të shumësit te emrat e tipit *mulli-nj*, *kufi-nj*, *fto-nj* etj., ose të atij të kohës së tashme te foljet e tipit t. *bë(n)j*, g. *bëj*³⁵. Ai është shoqëruar nga errësimi në /ə/ i zanores fundore, që u kushtëzua nga pozicioni (kryesisht) proklistik i njësisë në zanafillë. Të dyja këtyre dukurive u paraprin në kohë bjerrja e zanores nistore të patheksuar: khs. *tetë* < protoshq. ⁰/aktō-tV-/ : ie. ⁰/(H)oktoh₃/ (§ 2.3.).

Bardhyl DEMIRAJ

THE NUMERAL ONE (NJË) IN ALBANIAN - A DIACHRONICAL APPROACH

Summary

Numeral one in the Albanian language, with its phonetic form /ñə/ <një>, standardised in literary language as well, has darkened its etymological links with any of the adjectival stems that have been proved in different Indo-European languages: * /oinos/..., Greek *oivn* f., *oivoç* m., lat. *unus* (*oinos*), old Ir. *oén*, Goth. *ains* ...

In connection to the origin of this numeral in Albanian, opinions have been expressed by many scholars, such as Brugmann, Sh. Demiraj, Çabej, Camarda, Meyer, Jokl, La Piana, etc.

On the basis of phonetic developments in Albanian at diachronic level and the function of numeral një, the matter of its origin seems to result to the favour of pronoun stem */h en-/. Within this framework numeral një is explained without any difficulty by * /-<o-/ (f. * /<eh-/ of pronominal stem */h en-/: një < proto-Alb. /an<V/): m. * /h en-<o-/, f. /h en-<eh-/.

35 Sh. përkëtë Çabej *Hyrje* 114; Demiraj *Gramatikë* 141v.